

ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga
gjurmimi i të
diplomuarve
2018-2022



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J).
Koordinator për gjurmimin në Shkollën “Ali Myftiu”: Alketa Kanani

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)	7
Figura 2: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)	7
Figura 3: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022).....	8
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022)	9
Figura 5: Punësimi përkundrejt vetëpunësimit (2018-2022).....	9
Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)	10
Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022).....	10
Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2018-2022).....	11
Figura 9: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022.....	13
Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2022).....	14
Figura 11: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022).....	15
Figura 12: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2018-2022) ...	15
Figura 13: Madhësia e kompanisë (2018-2022)	16
Figura 14: Lloji i kontratës (2018-2022)	17
Figura 15: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022).....	17
Figura 16: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022).....	18
Figura 17: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022).....	21
Figura 18: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)	21
Figura 19: Lloji i institucionit (2020-2022)	22
Figura 20: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022).....	22
Figura 21: Papunësia ndër vite (2018-2022).....	23
Figura 22: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021).....	23
Figura 23: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022).....	24
Figura 24: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022)	25
Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022).....	26

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit.....	6
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)	11
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022).....	12
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)	12
Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022).....	18
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022).....	19
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022).....	19
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022)	20
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022).....	23
Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022)	24
Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)	25
Tabela 12: Përçindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022)	26
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022).....	27
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022).....	27

Tabela e përmbajtjes


1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?	5
2. Të diplomuarit 2018-2022	6
3. Analiza e rezultateve.....	8
3.1 Statusi i punësimit.....	8
3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit	10
3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës	11
3.4 Niveli i pagave.....	12
3.5 Kushtet e punës	15
3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....	17
3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....	18
3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....	19
3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme	20
3.10 Të diplomuarit pa punë.....	23
3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë	25
3.12 Planet për të ardhmen	27
4 Përfundime	28

1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla “**Ali Myftiu**”, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i

maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **pesë brezave me të diplomuar** të shkollës “Ali Myftiu”.

2. Të diplomuarit 2018-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në shkollën “Ali Myftiu”, u diplomuan 155 nxënës (shiko tabelën 1). Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 77 nxënës ose 50% e të diplomuarve. Të gjithë të diplomuarit e gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2017-2018	159	78	49%
2018-2019	203	95	47%
2019-2020	219	99	45%
2020-2021	135	58	43%
2021-2022	155	77	50%

Figura 1 paraqet shpërndarjen e të gjurmuarve sipas drejtimeve që ofron shkolla. Në vitin 2022, 44% e të gjurmuarve kanë ndjekur drejtimin “Shërbime Mjetesh Transporti” (SHMT), 21% drejtimin “Elektroteknikë”, 18% drejtimin “Ndërtim” dhe 17% drejtimin “Mekanikë”.


Figura 1: Shpërndarja sipas drejtimeve (2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=77

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 90% (N=69) e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri, dhe 10% (N=8) jashtë vendit (shiko figurën 2). Mesatarisht për vitet 2020-2021, 79% e të diplomuarve jetojnë në Shqipëri dhe 21% jetojnë jashtë vendit një vit pas diplomimit.

Figura 2: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77)


Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë vendit, 4 (katër) jetojnë në Gjermani, 2 (dy) në Greqi dhe 2 (dy) në Itali.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 77 të anketuarish 53% (N=41) ishin të punësuar, 8% (N=6) ishin të vetëpunësuar, 9% (N=7) ishin student/kursant dhe 4% (N=3) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 26% (N=20) të diplomuar një vit pas diplomimit.

Figura 3: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=77

Referuar figurës 4, në vitin 2022, 65% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Viti 2022 shënon një rritje të punësimit me 19 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2021 e cila ka qenë 46%. Viti që ka shënuar shkallën më të ulët të punësimit ka qenë viti 2018 me vetëm 35% të të diplomuarve të punësuar.

Ndërkohë, 26% e të diplomuarve në vitin 2022, janë të papunë. Mesatarisht, për vitet 2018-2021, 41% e të diplomuarve kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit. Si rezultat, për vitin 2022 kemi një ulje të papunësisë me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021.

Ndërkohë, 9% e të diplomuarve të vitit 2022 janë student/kursant. Mesatarisht, në vitet 2018-2021 13% e të diplomuarve kanë qenë student/kursant. Pra, kemi një ulje me 4 pikë përqindje të atyre që vijojnë studimet e mëtejshme për vitin 2022 në raport me mesataren e viteve 2018-2021.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=78); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2022, 53% e të diplomuarve janë të punësuar dhe 8% të vetëpunësuar (shiko figurën 5). Vërehet një rritje me 18 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (35%) e punësimit në raport me vetëpunësimin. Ndërkohë, mesatarja e vetëpunësimit në vitet 2018-2021 ka qenë 7%. Si rezultat, kemi një rritje të vetëpunësimit me 1 pikë përqindje për vitin 2022.

Figura 5: Punësimi përkundrejt vetëpunësimit (2018-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=78); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77).

Në figurën 6, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 75% (N=12) e të diplomuarve në Elektroteknikë, 69% (N=3) e të diplomuarve në Mekanikë, 64% (N=9) e të diplomuarve në Ndërtim dhe 59% (N=20) e të diplomuarve në SHMT janë të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë janë 29% (N=10) e të diplomuarve në SHMT, 29% (N=4) e të diplomuarve në Ndërtim, 23% (N=3) e të diplomuarve në

Mekanikë dhe 19% (N=3) e të diplomuarve në Elektroteknikë. Lidhur me ndjekjen e studimeve të mëtejshme, përkatësisht nga një i/e diplomuar në Elektroteknikë, Mekanikë dhe Ndërtim si dhe katër të diplomuar në SHMT vijnë studimet e mëtejshme.

Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** E (N=16); M (N=13); N (N=14); SHMT (N=34)

3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit (shiko figurën 7), 56% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, po aq sa mesatarja e viteve 2018-2021. Ndërkohë, 44% u shprehën që puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Edhe këtu nuk kemi ndryshim nga mesatarja e viteve 2018-2021.


Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=27); 2019 (N=35); 2020 (N=52); 2021 (N=34); 2022 (N=50)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 8), vërehet se mesatarisht (2020-2022) 58% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 39% e të diplomuarve në Mekanikë, 61% e të diplomuarve në Ndërtim dhe 55% e të diplomuarve në SHMT pohojnë lidhje mes punës dhe fushës së tyre të arsimit.

Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020:** N_E=21; N_M=14; N_N=2; N_{SHMT}=15; **Baza 2021:** N_E=13; N_M=1; N_N=4; N_{SHMT}=16; **Baza 2022:** N_E=12; N_M=9; N_N=9; N_{SHMT}=20

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin dy arsye kryesore: (i) pagë/kushte më të mira të punës aktuale (53%), dhe (ii) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet e tyre (35%). Ndërkohë, mesatarisht 19% e të diplomuarve 2018-2021, janë shprehur se arsye e mospërputhjes së punës me fushën e tyre të studimit ka qenë paga/kushtet më të mira të punës aktuale. Si rezultat, për vitin 2022 kemi një rritje me 34 pikë përqindje në këtë kategori. Nga ana tjetër, lidhur me pamundësinë e gjetjes së një vendi pune që lidhet me studimet e tyre vëreht një rënie me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (45%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	36%	55%	61%	27%	35%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	9%	0%	7%	6%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	9%	18%	11%	20%	6%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	0%	9%	28%	40%	53%
Tjetër	55%	9%	0%	7%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=11); **2019** (N=11); **2020** (N=18); **2021** (N=15); **2022** (N=17)

3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 40% e të gjurmuarve. Mesatarisht, 29% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 kanë pohuar se i përdorin “shumë/jashtëzakonisht shumë” njohuritë e fituara në shkollë. Si rezultat, për vitin 2022 vërehet një rritje me 11 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se i

përdorin “shumë/jashtëzakonisht shumë” njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës.

Ndërkohë, 26% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 22%. Pra, kemi ndër vite një ulje me 4 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin “aspak” njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin “disi” për vitin 2022 është 20%. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2021 ka qenë 29%. Pra, kemi një ulje me 9 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët pohojnë që i përdorin “disi” njohuritë e fituara gjatë studimeve në vendin e punës.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	30%	22%	22%	15%	11%
Të diplomuar në 2019	17%	14%	31%	17%	21%
Të diplomuar në 2020	23%	19%	27%	13%	17%
Të diplomuar në 2021	21%	15%	35%	9%	21%
Të diplomuar në 2022	26%	14%	20%	24%	16%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2018 (N=27); 2019 (N=42); 2020 (N=52), 2021 (N=34); 2022 (N=50)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 38% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 40% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve. Mesatarisht, 32% e të diplomuarve në vitet 2018-2021 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve “shumë/jashtëzakonisht shumë” dhe 42% me “pak/aspak”. Si rezultat, vërehet një rritje e numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë lidhje mes pozicionit aktual të punës dhe studimeve me 6 pikë përqindje. Ndërkohë, është ulur me 2 pikë përqindje numri i atyre që e vlerësojnë “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2022)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
Të diplomuar në 2018	22%	22%	33%	7%	15%
Të diplomuar në 2019	26%	14%	26%	17%	17%
Të diplomuar në 2020	25%	17%	27%	17%	13%
Të diplomuar në 2021	24%	18%	18%	26%	15%
Të diplomuar në 2022	28%	12%	22%	22%	16%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: 2018 (N=27); 2019 (N=42); 2020 (N=52); 2021 (N=34); 2022 (N=50)

3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 9), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 2% më pak se paga minimale, 8% paga minimale – 35,000 lekë, 50% marrin 35,001 – 50,000 lekë, 12% marrin 50,001 – 65,000 lekë, 8% marrin 65,001 – 80,000 lekë dhe 20% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Sikurse

vihet re nga figura, gjysma e të diplomuarve të gjurmuar (N=25), paguhen mes 35,001 dhe 50,000 lekë. ndërkohë, 10 nga 50 të diplomuarit paguhen më shumë se 80,001 lekë.

Figura 9: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=50

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 10), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Për vitin 2022, 2% e të diplomuarve të gjurmuar merr një pagë më të ulët se paga minimale, me një përmirësim me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021, ku 10% e të diplomuarve merrnin më pak se paga minimale. Sikurse e tregon edhe figura 10, viti 2022 shënon numrin më të ulët të atyre që marrin një pagë më të ulët se paga minimale (N=1). Ndërkohë, përqindja e të diplomuarve të gjurmuar që marrin një pagë deri në 35.000 lekë është ulur me 24 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (32% mesatarja, 8% në 2022).

Nga ana tjetër, është rritur me 18 pikë përqindje numri i të diplomuarve që marrin një pagë 35,001 - 50,000 lekë. (32% mesatarja 2018-2021, 50% në 2022). Ndërkohë, numri i të diplomuarve që marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë është rritur me vetëm 1 pikë përqindje. Gjithashtu, me 1 pikë përqindje është rritur numri i të diplomuarve që marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë (7% mesatarja, 8% në 2022).

Viti 2022, shënon edhe rritje në përqindjen e të diplomuarve që marrin një pagë më shumë se 80,001 lekë. Kështu, 20% e të diplomuarve në vitin 2022 marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë, ndërkohë mesatarisht nga viti 2018-2021, vetëm 8% e të diplomuarve të gjurmuar e kanë marrë këtë pagë.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=27); 2019 (N=35); 2020 (N=52), 2021 (N=34); 2022 (N=50)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 11), vëmë re se vetëm 5% (N=1) e të diplomuarve në SHMT marrin më pak se paga minimale. Ndërkohë, një pagë deri në 35,000 lekë e marrin 22% (N=2) e të diplomuarve në Ndërtim dhe 10% (N=2) e të diplomuarve në SHMT.

Sikurse u vu në dukje edhe më sipër, gjysma e të diplomuarve të gjurmuar marrin një pagë 50,001 – 50,000 lekë. Me këtë fashë page paguhen 78% e të diplomuarve në Mekanikë, 60% e të diplomuarve në SHMT, 33% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 22% e të diplomuarve në Ndërtim.

Ndërkohë, vetëm 22% e të diplomuarve në Ndërtim dhe 20% e të diplomuarve në SHMT marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Pagën 65,001 – 80,000 lekë e merr nga 1 (një) i diplomuar në secilën degë. Për më tepër, 58% (N=7) të diplomuar në Elektroteknikë, 22% (N=2) të diplomuar në Ndërtim dhe 11% (N=1) të diplomuar në Mekanikë marrin më shumë se 80,001 lekë.

Figura 11: Niveli i pagave sipas drejtimit (2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N_E=12; N_M=9; N_N=9; N_{SHMT}=20

3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të pestë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht 87% e të diplomuarve (2018-2022) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 8% e të diplomuarve (2018-2021) punojnë me kohë të pjesshme dhe 4% me kohë të plotë sezonale.

Figura 12: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë punësimit me kohë të pjesshme (2018-2022)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumat e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=25); 2019 (N=30); 2020 (N=43); 2021 (N=27); 2022 (N=44)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë, sikurse e tregon edhe figura 13, mbizotëron punësimi në kompani me 1-4 punonjës. Në brezin e fundit të të gjurmuarve (2022), 32% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, me një ulje me 17 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2022. Ndërkohë, 14% punojnë në kompani me 5-9 punonjës (23% mesatarja 2018-2021).

Në kompani me 10-49 punonjës punojnë 27% e të diplomuarve të gjurmuar (13% mesatarja 2018-2021). Gjithashtu, 27% e të diplomuarve punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës (14% mesatarja e viteve 2018-2021).


Figura 13: Madhësia e kompanisë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=25); 2019 (N=30); 2020 (N=43), 2021 (N=27); 2022 (N=44)

Në vitin 2022, 55% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 36% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 18% me afat të caktuar. Ndërkohë, 43% nuk kanë një kontratë me punëdhënësin e tyre. Ndonëse numri i këtyre të fundit mbetet i lartë, për vitin 2022 vërehet një përmirësim me 12 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 ku 55% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin e tyre.


Figura 14: Lloji i kontratës (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=25); 2019 (N=30); 2020 (N=43), 2021 (N=27); 2022 (N=44)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të pesë brezave, 67% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 15). Ndërkohë, mesatarisht 28% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 5% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 15: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=25); 2019 (N=30); 2020 (N=43), 2021 (N=27); 2022 (N=44)

3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 70% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 5). Këtu vërehet një rritje me 12 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (58%). Ndërkohë, 9% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen “shumë të pasigurt”. Mesatarisht, nga viti 2018-

2021, 8% e të diplomuarve kanë pohuar se ndjeheshin “shumë të pasigurt”. Pra, vërehet një rritje e pasigurisë me 1 pikë përqindje.

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 65% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 7% u shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Shumë i/e pasigurt	4%	7%	7%	15%	9%
I/e pasigurt	12%	0%	7%	11%	2%
Neutral	32%	30%	19%	26%	18%
I/e sigurt	48%	33%	37%	26%	45%
Shumë i/e sigurt	4%	30%	30%	22%	25%
Shumë i/e pakënaqur	4%	13%	7%	7%	7%
I/e pakënaqur	4%	3%	7%	15%	5%
Neutral	36%	27%	14%	26%	23%
I/e kënaqur	48%	40%	51%	26%	45%
Shumë i/e kënaqur	8%	17%	21%	26%	20%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=25); 2019 (N=30); 2020 (N=43), 2021 (N=27); 2022 (N=44)

3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 43% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, 11% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 19% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, dhe 19% të tjerë janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit, 4% janë punësuar 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë 6% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 16: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=54

Në një vështrim krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 51% e të diplomuarve 2018-2021 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një ulje me 8 pikë përqindje për vitin 2022, ku 43% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 16% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2018-2021). Në këtë kategori kemi një ndryshim me 5 pikë përqindje për vitin 2022, ku 11% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit. Ndryshim me 12 pikë përqindje kemi në kategorinë e atyre që e gjejnë punën 1 – 3 muaj pas diplomimit (19% 2022, 7% mesatarja e viteve 2018-2021).

Ndërkohë, është rritur me 6 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 3 - 6 muaj pas diplomimit (19% në 2022, përkundrejt 13% (mesatarja) në vitet 2018-2021), si dhe është ulur me 4 pikë përqindje numri i të diplomuarve që gjejnë punë 6 – 9 muaj pas diplomimit (4% në 2022, 8% mesatarja e viteve 2018-2021). Gjithashtu, është rritur me 2 pikë përqindje numrin i atyre që gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit (6% në 2022, 4% mesatarja e viteve 2018-2021).

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Para diplomimit	38%	57%	42%	67%	43%
1 muaj pas diplomimit	13%	16%	16%	21%	11%
1 - 3 muaj pas diplomimit	13%	5%	12%	0%	19%
3 - 6 muaj pas diplomimit	23%	14%	14%	3%	19%
6 - 9 muaj pas diplomimit	10%	5%	10%	6%	4%
9 - 12 muaj pas diplomimit	5%	3%	6%	3%	6%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=40); 2019 (N=37); 2020 (N=50); 2021 (N=33); 2022 (N=54)

3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të pestë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht 66% e të diplomuarve gjatë viteve 2018-2021 kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2022 kjo përqindje është 61%, duke shënuar një ulje me 5 pikë përqindje për këtë kategori.

Mënyrë tjetër për gjetjen e punës së parë është praktika profesionale në biznes. Mesatarisht, 13% e të diplomuarve gjatë viteve 2018-2021 e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes. Vërehet një rritje me 9 pikë përqindje në këtë kategori për vitin 2022, ku 22% e të diplomuarve janë shprehur se e kanë gjetur punën e parë falë praktikës profesionale në biznes.

Mënyra e tretë mbizotëruese është nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta. Mesatarisht, gjatë viteve 2018-2021, 7% e të diplomuarve e kanë gjetur punën e parë falë njoftimeve për punë. Këtu vërehet një rritje me 2 pikë përqindje për vitin 2022 ku 9% e të diplomuarve e gjetën punën falë njoftimeve.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	8%	5%	12%	3%	9%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	75%	70%	54%	64%	61%
Nga praktika profesionale në biznes	10%	11%	8%	24%	22%

Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	5%	5%	26%	3%	2%
Nga mësuesit	0%	3%	0%	0%	2%
Nga Zyra e Punësimit	0%	3%	0%	0%	0%
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	3%	0%	0%	2%
Tjetër	3%	0%	0%	6%	2%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=40); 2019 (N=37); 2020 (N=50); 2021 (N=33); 2022 (N=54)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2022, 46% pohuan se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës së parë, me një rritje me 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (37%). Ndërkohë, 24% pohojnë se shkolla i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, me një rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (30%). Për më tepër, 22% pohojnë se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë, me një rritje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (17%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	63%	40%	21%	26%	14%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	48%	33%	29%	9%	24%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	33%	14%	4%	15%	22%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	30%	26%	50%	44%	46%
Tjetër	7%	2%	2%	9%	4%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=27); 2019 (N=42); 2020 (N=52); 2021 (N=34); 2022 (N=50)

3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2022, vetëm 4% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2018-2021 ka qenë 3%. Në këtë aspekt kemi një rritje me 1 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 9% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2022 shprehen se janë student/kursantë. Këtu vërehet një rritje me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (13%).


Figura 17: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=78); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2022 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 70% (7 nga 10 të gjurmuar) dhe 30% (3 nga 10), ndjekin një kurs profesional.


Figura 18: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=14); 2019 (N=18); 2020 (N=7); 2021 (N=12); 2022 (N=10)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 80% (N=8) studiojnë në institucione publike dhe 20% (N=2) në ato private. Në dy vitet e mëparshme (2020-2021), të gjithë të diplomuarit e gjurmuar që ndiqnin studime të mëtejshme pohonin se studionin në institucione publike. Në këtë aspekt kemi një rënie me 20 pikë përqindje për vitin 2022.


Figura 19: Lloji i institucionit (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=7); 2021 (N=12); 2022 (N=10)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 20), për të diplomuarit e vitit 2022 kemi një ndarje të barabartë mes atyre që e pohojnë lidhjen mes studimeve me profesionin (50%) dhe atyre që e mohojnë (50%). Kështu, vërehet një rrënie me 12% e të diplomuarve që pohojnë lidhjen mes studimeve dhe profesionit dhe një rritje me po 12% e atyre një shprehen se studimet nuk kanë lidhje me profesionin e tyre.

Figura 20: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=7); 2021 (N=12); 2022 (N=10)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 40% e të diplomuarve në 2022 janë përgjigjur për të rritur mundësinë për të gjetur një punë më të mirë (35% mesatarja e viteve 2018-2021), 30% për të fituar një kualifikim më të lartë (52% mesatarja e viteve 2018-2021) dhe 30% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (7% mesatarja e viteve 2018-2021).

Tabela 9: Arsyt kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2022)


	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Për të fituar një kualifikim më të lartë	71%	53%	43%	42%	30%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	29%	20%	43%	50%	40%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	0%	27%	0%	0%	30%
Nuk po gjeja dot punë	0%	0%	14%	0%	0%
Tjetër	0%	0%	0%	8%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=14); 2019 (N=15); 2020 (N=7); 2021 (N=12); 2022 (N=10)

3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2022 është 26% (N=20), me një ulje me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (41%). Sikurse vihet re nga figura 21, viti 2022 shënon nivelin më të ulët të papunësisë ndër vite.


Figura 21: Papunësia ndër vite (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=78); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 65% e të diplomuarve të papunë të vitit 2022 u përgjigjën që ishin në kërkim të një pune. E shprehur në numër absolut 13 nga 20 të diplomuarit e papunë janë në kërkim të një pune. Mesatarisht në vitet 2020 dhe 2021, 61% e të diplomuarve të papunë janë shprehur se ishin në kërkim të një pune. Si rezultat, kemi një rritje me 4 pikë përqindje të të diplomuarve të papunë që janë në kërkim të një pune.

Figura 22: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2021)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=42); 2021 (N=16); 2022 (N=20)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: (i) mungesa e ofertave për punë në qarkun e banimit (62% në 2022, 24% mesatarja e viteve 2018-2021), (ii) oferta për punë që nuk lidhen me arsimimin (23% në 2022, 12% mesatarja e viteve 2018-2021) dhe (iii) mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur punë (15% në 2022, 21% mesatarja e viteve 2018-2021).


Tabela 10: Arsyet kryesore pas papunësisë (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Më mungon eksperiencia e punës	14%	20%	18%	11%	0%
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	5%	5%	7%	0%	0%
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	8%	5%	14%	22%	23%
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	24%	16%	11%	33%	15%
Nuk ka punë në qarkun tim	22%	14%	29%	33%	62%
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	0%	7%	0%	0%
Tjetër	27%	14%	14%	0%	0%
Nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-19	0%	27%	0%	0%	0%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=37); 2019 (N=44); 2020 (N=28); 2021 (N=9); 2022 (N=13)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 23), për vitin 2022, 62% e të diplomuarve të papunë që janë në kërkim të një pune shprehen se po kërkojnë punë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta. Këtu vërehet një rritje me 35 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2020-2021 (27%). Për më tepër, 46% e të diplomuarve të papunë kërkojnë punë nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve me një ulje me 16 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2020-2021 (62%).

Figura 23: Metodatat e kërkimit për punë (2020-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=28); 2021 (N=9); 2022 (N=13)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 11), 2 (dy) të diplomuar u shprehën se nuk kishin besim se do gjenin një punë dhe 2 (dy) të tjerë se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Për më tepër, 2 (dy) të diplomuar të papunë që nuk po kërkonin punë u shprehën se kishin në plan të largoheshin nga vendi, po aq sa edhe viti i mëparshëm. Ndërkohë, dëshira për emigrim ka pësuar një rënie në raport me vitin 2020 ku 8 (tetë) të diplomuar të papunë parashikonin të largoheshin nga vendi.


Tabela 11: Arsyet kryesore e mos kërkimit për punë (2020-2022)

	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Po pres të filloj punë së shpejti	14%	29%	0%
Nuk kam besim se do gjej një punë	14%	0%	29%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	14%	14%	29%
Kam në plan të largohem nga vendi	57%	29%	29%
Kujdesem për fëmijët/familjen	0%	14%	0%
Tjetër	0%	14%	14%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2020 (N=14); 2021 (N=7); 2022 (N=7)

Sikurse e tregon edhe figura 28, niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë është rritur në mëyrë të vazhduar nga viti 2019, për të arritur në masën 50% në vitin 2022. Mesatarisht, nga viti 2018 deri në vitin 2022, 32% e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herët në marrëdhënie pune.

Figura 24: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=37); 2019 (N=44); 2020 (N=42); 2021 (N=16); 2022 (N=20)

3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit, është tek nevoja për përmirësimin e praktikës në biznes (55%), me një rritje me 2 pikë përqindje krahasuar me

mesataren e viteve 2018-2021 (53%), praktikës në shkollë (50%), me një rritje me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (54%), si dhe bashkëpunimi me bizneset (43%), me një rritje me 6 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (49%). Për më tepër, kërkohet të përmirësohet këshillimi i karrierës (40%), bashkëpunimi me zyrat e punësimit (35%), si dhe aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (35%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
<i>Infrastruktura</i>	11%	29%	58%	49%	27%
<i>Kurrikula</i>	11%	26%	51%	52%	21%
<i>Tekstet dhe materialet</i>	22%	33%	58%	47%	35%
<i>Metodat e mësimdhënies</i>	19%	38%	63%	53%	27%
<i>Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve</i>	19%	43%	60%	57%	35%
<i>Praktika në shkollë</i>	26%	60%	67%	64%	50%
<i>Praktika në biznes</i>	37%	55%	61%	60%	55%
<i>Këshillimi i karrierës</i>	11%	52%	56%	52%	40%
<i>Bashkëpunimi me bizneset</i>	26%	55%	62%	52%	43%
<i>Bashkëpunimi me zyrat e punësimit</i>	33%	55%	61%	61%	35%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=27); 2019 (N=42); 2020 (N=88); 2021 (N=46); 2022 (N=63)

Nëse do të kishin mundësi, 79% e të diplomuarve në vitin 2022 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 75% të njëjtën shkollë (shiko figurën 25). Mesatarisht, nga viti 2018-2022, 76% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë, dhe 78% të njëjtën shkollë.

Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=78); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2022, 82% e të diplomuarve në SHMT, 81% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 77% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 71% e të diplomuarve në Ndërtim do të përzgjidhnin të njëjtën degë.

Ndërkohë, 85% e të diplomuarve në Mekanikë, 79% e të diplomuarve në SHMT, 75% e të diplomuarve në Elektrotekninë dhe 57% e të diplomuarve në ndërtim do të përzgjidnin të njëjtën degë.

Sikurse e tregon edhe tabela 13, të diplomuarit e degës Ndërtim, nga viti 2020 deri në vitin 2021, do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe shkollë në masën 100%. Ndërkohë, në vitin 2022, kemi një rënie me 29 pikë përqindje në përzgjedhjen e së njëjtës degë (71%) dhe 43 pikë përqindje në përzgjedhjen e së njëjtës shkollë (57%).

Rritje në mundësinë e përzgjedhjes së të njëjtës degë shprehin edhe të diplomuarit në SHMT me 12 pikë përqindje (70% mesatarja 2018-2021, 82% në 2022) si dhe në përzgjedhjen e së njëjtës shkollë me 7 pikë përqindje (72% mesatarja 2018-2021, 79% në 2022).

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2022)

		Ekonomi -Biznes	Elektronikë	Elektroteknikë	Mekanikë	Ndërtim	SHMT
Të diplomuar në 2018	Degë	67%		80%	65%		66%
	Shkollë	100%		96%	76%		88%
Të diplomuar në 2019	Degë		83%	82%	83%		82%
	Shkollë		100%	82%	96%		79%
Të diplomuar në 2020	Degë			92%	53%	100%	76%
	Shkollë			81%	53%	100%	54%
Të diplomuar në 2021	Degë			73%	100%	100%	56%
	Shkollë			73%	100%	100%	67%
Të diplomuar në 2022	Degë			81%	77%	71%	82%
	Shkollë			75%	85%	57%	79%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018:** N_{EB}=3; N_{ET}=25; N_M=17; N_{SHMT}=32; **Baza 2019:** N_E=6; N_{ET}=33; N_M=23; N_{SHMT}=33; **Baza 2020:** N_{ET}=37; N_M=19; N_N=6; N_{SHMT}=37; **Baza 2021:** N_{ET}=22; N_M=4; N_N=5; N_{SHMT}=27; **Baza 2022:** N_{ET}=16; N_M=13; N_N=14; N_{SHMT}=34

3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 43% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një rritje më 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (33%). Ndërkohë, 42% e të diplomuarve pohojnë se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 12 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (30%).

Për më tepër, 31% e të diplomuarve kanë dëshirë të jenë të punësuar, me një rritje me 12 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2021 (19%). Ndërkohë, për vitin 2022, 25% e të diplomuarve planifikojnë të emigrojnë jashtë vendit në dy vitet e ardhshme, me një ulje me 7 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2021 (32%). Dëshira për migrim të brendshëm vijon të mbetet zero për dy viteve e fundit.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2022)

	Të diplomuar në 2018	Të diplomuar në 2019	Të diplomuar në 2020	Të diplomuar në 2021	Të diplomuar në 2022
Të jem punësuar	30%	12%	21%	12%	31%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	40%	35%	27%	29%	43%

Të kem filluar biznesin tim	10%	22%	38%	48%	42%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	5%	15%	9%	19%	16%
Të kem emigruar jashtë vendit	38%	27%	36%	28%	25%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	3%	3%	3%	0%	0%
Tjetër	3%	9%	1%	0%	1%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza:** 2018 (N=77); 2019 (N=95); 2020 (N=99); 2021 (N=58); 2022 (N=77)

4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës “Ali Myftiu” duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2018.

Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 50% e të diplomuarve të vitit 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 77 të anketuarish 53% ishin të punësuar, 8% ishin të vetëpunësuar, 9% ishin student/kursant dhe 4% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 26% të diplomuarve të gjurmuar një vit pas diplomimit.
- 75% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 69% e të diplomuarve në Mekanikë, 64% e të diplomuarve në Ndërtim dhe 59% e të diplomuarve në SHMT janë të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë janë 29% e të diplomuarve në SHMT, 29% e të diplomuarve në Ndërtim, 23% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 19% e të diplomuarve në Elektroteknikë. Lidhur me ndjekjen e studimeve të mëtejshme, përkatësisht nga një i/e diplomuar në Elektroteknikë, Mekanikë dhe Ndërtim si dhe katër të diplomuar në SHMT vijnë studimet e mëtejshme.
- 56% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, po aq sa mesatarja e viteve 2018-2021. Ndërkohë, 44% u shprehën që puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit.
- Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 40%. Vërehet një rritje me 11 pikë përqindje në krahasim me mesataren e viteve 2018-2021.
- Për vitin 2022, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 2% më pak se paga minimale, 8% paga minimale – 35,000 lekë, 50% paguhen 35,001 – 50,000 lekë, 12% paguhen 50,001 – 65,000 lekë, 8% paguhen 65,001 – 80,000 lekë dhe 20% paguhen më shumë se 80,001 lekë. Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve: 5% e të diplomuarve në SHMT marrin më pak se paga minimale, 22% e të diplomuarve në Ndërtim dhe 10% e të diplomuarve në SHMT marrin një pagë deri në 35,000 lekë, 78% e të diplomuarve në Mekanikë, 60% e të diplomuarve në SHMT, 33% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 22% e të diplomuarve në Ndërtim marrin një pagë 50,001 – 50,000 lekë. Ndërkohë, 22% e të diplomuarve në Ndërtim dhe 20% e të diplomuarve në SHMT marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Pagën 65,001 – 80,000 lekë e merr nga 1 (një) i diplomuar për secilën degë. Për më tepër, 58% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 22% e të diplomuarve në ndërtim dhe 11% e të diplomuarve në Mekanikë marrin më shumë se 80,001 lekë.
- 43% e të diplomuarve në vitin 2022 kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, 11% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 19% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit dhe 19% të tjerë janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit, 4% janë punësuar 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë 6% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 70% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 65% “të kënaqur ose shumë të kënaqur. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 26%. Në numër absolut kjo shkon në 20 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 13 prej tyre (65%) janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatësisht praktika në biznes (55%), praktika në shkollë (50%), bashkëpunimi me bizneset (43%), këshillimi i karrierës (40%) kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme, 43% e të diplomuarve në vitin 2022 shpresojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit dhe 42% të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje për vitin 2022 kanë shënuar një rritje me 12 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2018-2021 (30%).